



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL PËR EFEKT MARRJEN E
SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE TË LËNDËS GJUHË FRËNGE
2014**

1) HYRJE

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Gjuhës Frënge është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit – IZHA, për t’u ardhur në ndihmë të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve, si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së Gjuhës Frënge për t’u përgatitur për testimin kombëtar për marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi është zhvilluar duke iu përgjigjur kërkesave që MAS-i ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- dokumentet zyrtare¹ të cilat kanë të bëjnë me veprimtarinë mësimore – edukative të mësuesve;
- programet përkatëse lëndore;
- aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie në përgjithësi, si dhe të lëndës së Gjuhës frënge në veçanti;
- aspekte të etikës dhe komunikimit;
- aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- përmbajtjen shkencore të lëndës së Gjuhës frënge sipas programeve lëndore përkatëse.

2) QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të gjuhës frënge është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të tyre. Programi është hartuar nga grupi i punës duke mbajtur parasysh përmbushjen e dy qëllimeve kryesore.

- *Së pari*, të ofrohet si një program orientues për t’u ardhur në ndihmë Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave të Arsimit të rretheve si dhe të gjithë mësuesve të lëndës së Gjuhës

¹ Është fjala për të gjitha dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MAS që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

frënge në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese në bazë rrethi. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete.

- *Së dyti*, si një program i detyruar, veçanërisht për mësuesit që këtë vit do të marrin shkallët e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje gjithëvjetoje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit arsimor e në mënyrë të veçantë të risive më të fundit të reformës arsimore.
- Rritjen e aftësive dhe kompetencave profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor, drejt një mësimdhënieje të suksesshme.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për domosdoshmërinë e njohjes së koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim.
- Rritjen e përgjegjshmërisë së mësuesve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë.
- Rritjen e aftësive të mësuesve në drejtim të zbatimit me saktësi të rregullave drejtshkrimore të shqipes.
- Realizimin në praktikë nëpërmjet demonstrimit konkret të aftësive të fituara, e në mënyrë të veçantë nëpërmjet vlerësimit të arritjeve përmes testimit.

3) PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e shkallëve të kualifikimit të mësuesve të Gjuhës Frënge është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër, për të cilat testohen mësuesit. Për secilin fushë janë renditur njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë mësuesi i lëndës së Gjuhës frënge që të përmbushë me sukses rubrikat e testimit.

Programi është ndërtuar duke pasur si pikënisje standardet bazë të përgjithshme të mësuesit, si dhe në standardet e mësuesit të lëndës së Gjuhës frënge. Përshkallëzimi i kompetencave profesionale që lidhen me secilën fushë të testimit do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë nevojat e tij si dhe çështjet në të cilat duhet të thellohet më shumë.

Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat që mësuesit duhet të zotërojë në fushën e njohurive dhe aftësive si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave.

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Fusha : Dokumentet zyrtare

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë dispozitat normative për arsimin parauniversitar, si: <ul style="list-style-type: none"> - parimet e përgjithshme. - puna mësimore dhe edukative, - provimet e liritimit dhe të pjekurisë, - veprimtari, olimpiadat, konkurse, - mësuesi - të drejtat dhe detyrat, - prindërit - të drejtat dhe detyrimet, - organet kolegjiale në shkollë • të njohë dhe zbatojë rregulloren e brendshme të shkollës; • të plotësojë me korrektësi dokumentacionin shkollor siç është regjistri, evidencat, dëftesat etj; • të tërheqë në mënyrë të vazhdueshme fëmijët/të rinjtë në përvoja të përshtatshme, që mbështesin zhvillimin e tyre intelektual, social dhe personal; • të zhvillojë veprimtari të përshtatshme, që nxisin progresin e nxënësve; • të marrë vendime në dobi të zhvillimit fizik, social dhe emocional të nxënësve; • të promovojë një komunikim efektiv në kontaktet direkte me nxënësit për të drejtat e tyre; • të programojë për çdo orë mësimi, në punën e tij të përditshme objektiva sipas tre niveleve të objektivave të arritjes; • të reflektojë në orët e tij të lira arritjet e fundit të metodologjisë të mësimdhënies; • të zbatojë rregullat e ndërtimit dhe të punës në grup dhe në ekip; • të përdorë mënyra të larmishme për të shkëmbyer informacionin me kolegët; • të marrë pjesë në veprimtari të gjera kombëtare përmes të cilave evidentohen arritjet e nxënësve (konkurse, olimpiada); • të marrë masa dhe informojë nxënësit për masat e ruajtjes së jetës dhe të shëndetit të tyre nga rreziqet e ndryshme; • të kërkojë mundësi të vazhdueshme për të ndërtuar një partnership të fortë me prindërit dhe anëtarët e komunitetit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë. • Urdhri për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN), Nr 343, datë 19.08.2013. • Kodi Etik 2013 • Udhëzimi Nr. 49, dt. 27.12.2006 i MASH "Për hartimin e objektivave të arritjeve të nxënësve". • Udhëzimi Nr.38 , dt.09.10.2007 i MASH "Për zhvillimin e orëve të lira në shkollë". • Udhëzimi Nr. 35, dt.09.10.2007 i MASH "Për lirinë e mësuesit për orët mësimore të parashikuara në programin lëndor". • Udhëzimi Nr. 37, dt.09.10.2007 i MASH "Për paraqitjen e personelit të shkollës në mjediset shkollore". • Udhëzim Nr. 16, dt. 24.07.2012 për vitin shkollor 2012-2013 në Sistemin Arsimor Parauniversitar. • Udhëzimi Nr. 21, datë 23.07.2010 "Për normat e punës mësimore edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e Arsimit Parauniversitar". • Udhëzimi i Altertekstit 2010-2011 dhe Paketa informuese "Altertekst 2012" • Rregullore për procesin e maturës shtetërore 2013 në Republikën e Shqipërisë, dt. 07.01.2013 • Rregulloren Nr 4998, datë 27.07.2010 për vlerësimin e nxënësit në gjimnaz • "Kualifikimi i mësuesve" – Teste 2008, 2009, 2010", IKT • Kuadri normativ dhe rregullues i veprimtarisë së institucioneve arsimore pasqyruar në Udhëzimin Nr. 46 ,date 23 .08.2013, "Për vitin shkollor 2013 - 2014 në Sistemin Arsimor Prauniversitar"

Fusha: Programet lëndore

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none">• të zotërojë lëndën e gjuhës frënge dhe metodat e mësimdhënies që përdor;• të përdorë prezantime dhe shpjegime të ndryshme të koncepteve që japin idetë bazë të gjuhës frënge dhe bëjë lidhjen e tyre me njohuritë e mëparshme të nxënësve;• të prezantojë dhe përdorë pikëpamje, teori dhe metoda të ndryshme kërkimi të gjuhës frënge si gjuhë e huaj;• të vlerësojë burimet e ndryshme të mësimdhënies dhe materialet kurrikulare për gjuhën frënge, sipas nivelit që jep mësim;• të nxitë nxënësit në gjenerimin e ideve dhe të hipotezave, në përputhje me metodat e kërkimit dhe standardeve të gjuhës frënge;• të zhvillojë dhe përdorë kurrikula që i inkurajojnë nxënësit të kërkojnë, pyesin dhe interpretojnë idetë nga këndvështrime të ndryshme;• të krijojë përvoja të ndryshme ndërdisiplinore që i lejojnë nxënësit të integrojnë njohuritë, aftësitë dhe metodat e kërkimit nga fusha të ndryshme, si fizikë-frëngjisht, histori-frëngjisht, gjeografi-frëngjisht etj;• të planifikojë në shkallë vjetore dhe për çdo mësim zhvillimin e aftësive të nxënësve, duke u siguruar atyre kushtet e nevojshme dhe duke u dhënë dhe vlerësuar detyrat dhe punimet e ndryshme;• të krijojë konfidencialitet në planifikimin e mësimdhënies duke iu përgjigjur interesave të nxënësve dhe të rinjve për gjuhën frënge;• të përqendrohet në cilësinë e të nxënit dhe në	<ul style="list-style-type: none">• Programi i lëndës të Gjuhës frënge për sistemin parauniversitar, respektivisht 3, 4 dhe 5 (arsimi fillor), 6,7,8 dhe 9 (arsimi nëntëvjeçar), 10, 11 dhe 12 (arsimi i mesëm),• Teksti i nxënësit të Gjuhës Frënge për sistemin parauniversitar, respektivisht 3, 4 dhe 5 (arsimi fillor), 6,7,8 dhe 9 (arsimi nëntëvjeçar), 10, 11 dhe 12 (arsimi i mesëm), të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.• Kurrikula e gjuhëve të huaja klasa 3-9; Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Toena, Tirane,1999;• Vizioni kurrikular klasa 3-9; instituti i Kurrikulës dhe standardeve, Tirane, 2003• Standardet e arritjes në gjuhën e huaj; Instituti i Kurrikulës dhe Standardeve, Tiranë, 2003.

<p>rezultatet e aktiviteteve që ka planifikuar;</p> <ul style="list-style-type: none"> të planifikojë aktivitete në bashkëpunim me nxënësit dhe të rinjtë dhe me kolegë duke realizuar veprimtari multidisiplinore, komunitare, globale. 	
---	--

Fusha : Aspekte të pedagogjisë dhe metodologjisë në mësimdhënie-nxënie

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> të zhvillojë mësimdhënie alternative, të gjuhës frënge, nëpërmjet mësimeve të organizuara mirë për çdo sekuencë, duke përdorur strategjitë e përshtatshme, metodat zhvilluese, teknologjitë e të nxënitë si dhe duke kombinuar punën individuale me punën në grup; të rishikojë në vazhdimësi efektshmërinë e mësimdhënies të gjuhës frënge dhe ndikimin e saj në ecurinë e nxënësve, duke mbajtur parasysh arritjet e synuara që në fillim të procesit; të këshillojë dhe drejtojë nxënësit për progresin e arritjeve të tyre , si dhe jetë i hapur me ta; të përdorë komunikim të qartë dhe të kuptueshëm me nxënësit, gjatë paraqitjes së ideve dhe koncepteve të reja, duke përdorur me efektivitet të plotë shpjegimet, pyetjet dhe diskutimet e duhura; të administrojë me efektivitet të mësuarit e individëve, grupeve dhe të gjithë klasave, duke e ndryshuar mësimdhënien e gjuhës frënge në përshtatje me fazat e mësimit dhe me nevojat e nxënësve; të përdorë me efektivitet pajisjet dhe teknikat audiovizuale, konkretizimet, punët praktike etj., për të përmbushur qëllimet dhe objektivat e mësimit; të demonstrojë përkushtim të plotë në mësimin e gjuhës frënge; të motivojë nxënësit për të ngritur nivelin e tyre; të bëjë vetëkontroll të veprimtarive mësimore që kryen; të kërkojë, gjejë dhe përdorë metoda të 	<ul style="list-style-type: none"> Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin, metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës së huaj. Udhëzues dhe materiale mbështetëse që orientojnë për hartimin e objektivave të orës së mësimit, përgatitjen e ditarit të mësuesit, organizimin e orës së mësimit.

<p>vlerësimit të rolit të mësimdhënies në nxënien e nxënësve;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të jetë vazhdimisht i vëmendshëm ndaj progresit të nxënësve; • të krahasojë arritjet e veta dhe të nxënësve me statistika dhe standarde në nivel kombëtar për komponentë të ndryshëm të mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës frënge; • të përdorë vlerësime të shumëllojshme sistematike të arritjeve të nxënësve; • të hartojë pyetësorë dhe anketa për nxënësit; • të hartojë teste në vazhdimësi për matje dhe diagnostikim; • të reflektojë rreth arritjeve të nxënësve duke i orientuar ata drejt vetëvlerësimit që është një element shumë i rëndësishëm në mësimdhënien e gjuhës frënge. 	
Fusha: Aspekte të etikës dhe komunikimit	
<p>Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:</p>	<p>Literatura</p>
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • të sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së Mësuesve në Arsimin Parauniversitar Publik dhe Privat, i datës 12.11.2012. • Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.
Fusha: Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	
<p>Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:</p>	<p>Literatura</p>
<ul style="list-style-type: none"> • të njohë rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; • të zbatojë rregullat e drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Literaturë dhe udhëzues metodikë për përdorimin e rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
Fusha : Përmbajtja shkencore e lëndës	

Rezultati Mësuesi do të jetë i aftë:	Literatura
<ul style="list-style-type: none"> • të zotërojë gjuhën frënge; • të njohë strukturën e saj: ortografinë, fonetikën, fonologjinë, leksikun, semantikën, dhe gramatikën; • të tregojë aftësi në frëngjishten e folur, të shkruar, sipas regjistrave të gjuhës frënge; • të japë njohuritë e tij gjuhësore në mënyrë të kuptueshme dhe të pranueshme nga nxënësi; • të zhvillojë vetëdijen e nxënësit se si është strukturuar gjuha frënge dhe se si ajo krahasohet me gjuhën shqipe; • të njohë një numër të madh tekstesh të letërsisë dhe aspektesh kulturore të botës frëngjisht folëse; • të inkurajojë nxënësit të lexojnë, vlerësojnë dhe të kënaqen me literaturën e gjuhës frënge; • të lehtësojë interpretimin dhe analizën e pjesëve të literaturës së gjuhës frënge të përshtatshme për nxënësit e tij; • të krijojë mundësi që nxësin njohuritë dhe respektin për kulturat e tjera; • të rrisin ndërgjegjen e nxënësve për lidhjen midis gjuhës, literaturës dhe kulturës frënge; • të përdorë vëzhgimin, informacionin për nxënësit dhe kërkimin, si burime për vlerësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe nxënies së gjuhës frënge; • të kërkojë dhe shfrytëzon literaturë profesionale, si dhe burime të tjera për të mbështetur zhvillimin e vet profesional; • të zhvillojë aftësitë komunikuese për kërkim shkencor aktiv, për bashkëpunim dhe ndërveprim; • të tërheqë kolegët dhe profesionistët, brenda dhe jashtë shkollës, si mbështetje për reflektim, zgjidhje problemesh, shkëmbim idesh, përvojash të reja, marrje dhe dhënie informacioni të botës frankofone. 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës.